



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:061396

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06578557

KPPP.nr.2281/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arben Toska, në çështjen përmbartimore të kreditorëve 1) “DPT Drenusha” me NUI 810670415 me seli në rrugën Dëshmorët e Kombit 25/74 në Ferizaj, 2) “DPT Lepenci” me NUI 80011148 me seli në rrugën Dëshmoret e Kombit p.nr. në Ferizaj, të cilët përfaqësohet sipas prokurës nga avokati Daut Rudi me seli në rrugën Ismajl Raka p.nr. në Kaçanik, ndaj debitorit “Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS)” me NUI 810799364 dhe seli bulevardin Bill Clinton nr. 5 në Prishtinë, duke vendosur lidhur me propozimin për kundërpërmbartim të datës 06.10.2022 të debitorit në çështjen përmbartimore sipas urdhrorit përmbartimor P.nr.47/2022 të datës 14.01.2022 të përmbartuesit privat Sheremet Livoreka me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 29 nëntor 2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas propozimit për kundërpërmbartim të datës 06.10.2022 të debitorit “Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS)” me NUI 810799364 me seli në Prishtinë në çështjen përmbartimore sipas urdhrorit përmbartimor P.nr.47/2022 të datës 14.01.2022 të përmbartuesit privat Sheremet Livoreka me seli në Ferizaj.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamentit të Përgjithshëm, Divizioni Civil për të vendosur lidhur me këtë çështje përmbartimore.

**ARSYETIM**

Debitori në zyrën e përmbartuesit privat Sheremt Livoreka me seli në Ferizaj më datën 06.10.2022 ka ushtuar propozim për kundërpërmbartim (këtu e tutje Propozimi) me të cilin ka

kërkuar nga kjo gjykatë që të nxjerrë aktvendim me të cilin i detyron kreditorët që në afatin prej shtatë (7) ditësh t'ia kthejnë shumë e përgjithshme prej 136,288.25€ (57,336.77€ kreditori i parë, ndërsa 77,721.31€ kreditori i dytë) me kamatëvonesë prej 8% nga data 28.02.2022 deri në datën kur të kthehen në llogaritë e tij dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore në lartësi prej 1,230.17€ me kamatëvonesë prej me kamatëvonesë prej 8% nga data 28.02.2022 deri në datën kur të kthehen në llogaritë e tij.

Pas shqyrtimit paraprak të propozimit për kundërpërmbarrim dhe shkresave tjera të lëndës, gjykata vëren objekt i shqyrtimit është kundërpërmbarrimi, rrjedhimisht në bazë të nenit 19 dhe nenit 392 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së si dhe nenit 13 para. 1 nënpara. 1.2 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale (këtu e tutje LGJK) kryesisht e shqyrtoi kompetencën e vet lëndore, dhe gjeti se kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e këtij propozimi për kundërpërmbarrim është kompetente Gjykata Themelore në Ferizaj.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarrimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale ( Ligji nr. 08/L-15), me të cilin në paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarrimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Mjetet juridike në procedure përmbarrimore, sipas Ligji nr. 04/1-139 për Procedurën Përmbarrimore janë te përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarrimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit Ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarrimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarrueshëm për përmbarrimin me dhunë.”*

Tutje, Gjykata thekson se kompetenca në procedure përmbarrimore është e rregulluar me nenin 5 të LPP-së, ku sipas nën paragrafit 5 përcaktohet se: *“Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbarruese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose gfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga Përmbarruesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim ne Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku*

*gjendet selia e debitorit. Nëse debitori nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e se cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbarimi.”*

Andaj, konform dispozitave të lartcekura, Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Komerciale të Kosovës, është kompetent për shqyrtimin e mjeteve të rregullta në procedurë përmbarimore dhe atë prapësimi dhe ankesës, për çështje brenda kompetencës së kësaj gjykate, e që rrjedhimisht propozimi i paraqitur për kundërpërmbarim nuk bie në kompetencën e së njëjtës.

Në bazë të neneve 17 dhe 19, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet që gjykata gjatë tërë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore, e të cilat dispozita gjykata i zbatoi përshtatshmërisht në këtë procedurë konform nenit 17 të LPP-së.

Për këto arsye, në kuptim të nenit 392 para. 1 nënpara. b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së dhe dispozitat e cituara më lartë të LGJK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2281/2022

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese ndaj këtij aktvendimi brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.